



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË



Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit

### MBLEDHJE E BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë më 23.11.2016

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, pasi shqyrtoi relacionet e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE, u shpreh si më poshtë :

- Të shtyjë shqyrtimin e praktikës për fillimin e procedurës për heqjen e liçensës së shoqërisë "Dosku –Energy "shpk në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike Nr 134, Seria PV11P miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.67 date 27.07.2011.
- Miratimin e Vendimit "Mbi kërkesën e shoqërisë "EURON ENERGY" sh.p.k., për lënie peng asetesh në favor të Bankës "Societe Generale Albania"sh.a."
- Miratimin e Vendimit "Mbi kërkesën e shoqërisë "ENERGAL" sh.p.k., për lënie peng asetesh në favor të Bankës "Societe Generale Albania"sh.a."
- Miratimin e Vendimit "Në lidhje me disa ndryshime në rregulloren e përputhshmërisë së TAP AG".
- Rrëzimin e kërkesës, së shoqërisë " LUCENTE KONCESIONARE " sh.p.k., për liçensim në aktivitetin e Prodhimit të Energjise Elektrike nga Hec "Spatharë".
- Rrëzimin e kërkesës, së shoqërisë "LUÇENTE KONÇESIONARE" sh.p.k., për licensim në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Miratimin e Vendimit "Për disa ndryshime në Vendimin Nr.104 të Bordit të ERE, datë 23.06.2016, "Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të

paarritëshme si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE Nr.49, datë 21.10.2004, dhe Nr 146 datë 24.12.2013.

- Miratimin e Vendimit mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së tarifave për Furnizuesin e Shërbimit Universal.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**